



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 31-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 27.11.2024, në sallën numër 1, kati i 3-të, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Valon Pacolli

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës se bashku me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 30-të e KPF-së.
2. Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK- Lipjan. (Rishqyrtim).
3. Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit 2024-2029.

4. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr.15-462/01-35825 datë 25.07.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë.

6. Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA nga Raporti vjetor për PVF 2023.

7. Diskutimi i Raportit të Auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve për auditimin e kryer në Sektorin e tatimit në pronë.

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi rendin e ditës:

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 30-të e KPF-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimisht me 7 vota për Aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 29-të të KPF-së

II

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të paluajtshme të Komunës ZK- Lipjan. (Rishqyrtim).

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin

III

Propozim Vendim për miratimin e Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal të Komunës së Lipjanit 2024-2029.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor DEZH së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se shuma prej 33 milion për a vite është.

Valon Pacolli, tha se kjo shumë është për 3 vite dhe janë se bashku nga komuna, ministria dhe donatoret.

Arsim Jashari, tha se sa është shume qe komuna do ta ketë.

Valon Pacolli, tha se aq sa është e parapare me buxhet.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr.15-462/01-35825 datë 25.07.2024 për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolli drejtor i DEZH-së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha është mirë me shikuar ligjin pasi ende nuk është nënshkruar kontrata a ka mundësi ligjore qe të jetë fitues i dyti me radhë.

Valon Pacolli, tha se ne e kemi shikuar ligjin, mirëpo ligji nuk specifikon listë të pritjes.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për formimin e Komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste të Komunës në ZK Magurë.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit, drejtor i DEZH i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja me të gjitha votat prezentë 76 vota për, aprovoi propozimin.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se a pajtoheni qe pika e 6 dhe 7 e rendit te ditës të kalojnë direkt ne kuvend.

Diskutimi i Planit të veprimit për adresim të rekomandimeve të ZKA nga Raporti vjetor për PVF 2023.

Diskutimi i Raportit të Auditorit të brendshëm dhe planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve për auditimin e kryer në Sektorin e tatimit në pronë.

Me të gjitha votat prezentë 7 vota për, aprovoi propozimin.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 10:50

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Komitetit

Daut Azemi